

Nr. 2504/032 K (e-k) Prot.
Tiranë, më datë 29/04/2025

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda: DENONCIM Nr. 19 – Lidhur me përdorimin e burimeve publike për fushatë elektorale nga Kryeministri SH.T.Z. Edi Rama, Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastirliu dhe Kryetarja në detyrë e Bashkisë Tiranë Znj. Anuela Ristani, në përfitim të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

I nderuar z. Komisioner!

Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!

Në datën 2 prill 2024, në ambientet e Gjimnazit “Besnik Sykja” në Tiranë, është zhvilluar aktiviteti “*Transformimi i infrastrukturës arsimore, rritja e pagave për mësuesit, programet e reja për nxënësit dhe rritja e cilësisë së sistemit tonë arsimor janë sot një realitet i ri, drejt Shqipërisë 2030 në Bashkimin Europian*”.

Në këtë aktivitet, kanë marrë pjesë në cilësinë e folësit, Kryetarja në detyrë e Bashkisë Tiranë znj. Anuela Ristani, Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastirliu, si dhe Kryeministri SH.T.Z. Edi Rama.

Veprimtaria është pasqyruar gjerësisht më mediat audio-vizive si dhe në faqet zyrtare në internet dhe rrjetet sociale të institucioneve dhe drejtuesve të tyre.

Nga konsultimi i [ndërfaqes së raportimeve](#) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, **ky aktivitet nuk është raportuar.**

Referuar postimeve në faqet zyrtare në Facebook, ku videot janë LIVE, data e zhvillimit të aktivitetit është data 02.04.2025 në orën 16.00 (*print screen dhe link-et përkatëse mund t'i shihni në fund të këtij dokumenti Lidhja Nr.1*).

Sipas fjalës së Ministres së Arsimit dhe Sportit, në aktivitet kanë qenë të pranishëm përfaqësues të sistemit arsimor, mësues, si dhe prindër nga Këshillat e Prindërve të Tiranës.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në fillim të fjalës së saj (minuta 7 në [video](#)) Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur: “Përshëndetje të gjithëve ju. Dua t’ju falënderoj për këtë pjesëmarrje në këtë takim të sotëm të gjithëve ju, prindërit nga këshillat e prindërve të Tiranës, përfaqësues të sistemit tonë arsimor, mësuesit tanë të dashur, komunitetit të njesisë nr. 5 të Tiranës, në këtë takim ku do të flasim për arsimin për punët e mira që kemi bërë, por veçanërisht edhe për një prej aspekteve më të rëndësishëm të arsimit sikurse është infrastruktura arsimore. (...)”.

Nga fjalimet e Kryetares në detyrë të Bashkisë Tiranë, Ministres së Arsimit dhe Sportit dhe Kryeministrit, në takim **bëhet një paraqitjeve e arritjeve të qeverisë në fushën e arsimit**, me një fokus të veçantë në infrastrukturën arsimore, shkollat e ndërtuara si dhe rritjen e pagave të mësuesëve.

Fjalimet e tyre janë publikuar në faqet zyrtare të internetit të institucioneve përkatëse, si [Kryeministria](#) dhe [Ministria e Arsimit dhe Sportit](#). (Publikimet në faqet zyrtare të internetit të institucioneve, si dhe në faqet zyrtare në rrjetet sociale të institucioneve dhe drejtuesëve të tyre, janë paraqitur në Lidhjen nr. 1 në fund të këtij denoncimi).

Përpos fjalimeve, në [videon e publikuar](#) për këtë aktivitet, **vërehet shfaqja vizuale e banerave të cilët përmbajnë logon e Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si dhe premtimet elektorale për mandatin e katërt të synuar në këtë proces zgjedhor nga Partia Socialiste** lidhur me, përmirësimin e infrastrukturës së shkollave, ndërtimit të shkollave të reja si dhe rritjen e pagës së mësuesëve.

Këto elementë qartazi identifikojnë një aktivitet me përmbajtje elektorale.

Për ilustrim, disa printscreen-e më poshtë, ku shihet qartë “**mandati i katërt**”, premtimet përkatëse të PSSH, slogani elektor “**Shqipëria 2030**” si dhe **#PartiaSocialiste**:



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në gjykimin e KRIIK, **aktiviteti, pavarësisht nëse është institucional apo në kuadër të fushatës zgjedhore, përbën përdorim të burimeve publike dhe autoritetit shtetëror në funksion të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.**

I. Mundësia e parë

Nëse ky aktivitet do të konsiderohet si një takim me natyrë partiake e elektorale, atëherë aktiviteti qartas është zhvilluar në ambientet e një shkolle, **çka është në kundërshtim me ligjin.**

Nga këqyrja e videos së postuar mbi këtë takim (printscreen-et mund të shihni në fund të këtij dokumenti Lidhja Nr.1), takimi elektoral është zhvilluar në palestrën e shkollës.

Kodi Zgjedhor, në nenin 91 pika 1 dhe 2 përcakton se:

“ 1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”.

Gjithashtu, edhe Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3, pika 1.3/C përcakton se:

“veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.

Nga sa më sipër konstatohet se **Kryeministri, Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Kryetarja në detyrë të Bashkisë Tiranë kanë përdorur burime publike në mbështetje të fushatës elektorale të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe janë në shkelje të të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Gjithashtu, duke qenë se veprimtaria **veprimtaria elektorale është kryer në ambientet e palestres së shkolles, në shkelje të të njëjtës dispozite, ndodhet edhe Drejtuesi/ja e kësaj shkolle.**

Madje në këtë rast duke qenë se sipas Ministres së Arsimit pjesëmarrës janë *prindërit nga këshillat e prindërve të Tiranës, përfaqësues të sistemit tonë arsimor, mësuesit tanë të dashur, komunitetit të njësisë nr. 5 të Tiranës, etj., kemi të bëjmë me përdorimin e autoritetit shtetëror për pjesëmarrje të organizuar pas orarit zyrtar në funksion të një tubimi partiak e elektorale, çka përbën sërish shkelje të hapur të Ligjit.*

II. Mundësia e dytë

Nëse aktiviteti do të konsiderohet veprimtari e karakterit institucional, atëherë:

1. Aktiviteti është i pa raportuar në ndërfaqen e KQZ.
2. Aktiviteti është përdorur për qëllime dhe përfitime elektorale në përfitim të Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Kodi Zgjedhor, në nenin 92 pika 1 përcakton se: “1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, **janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.**”

Kodi Zgjedhor në nenin 81 në pikën 3 përcakton se: “Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, inaugurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor”.

Referuar gjithë sa më sipër, në gjykimin e KRIIK, **aktiviteti objekt denoncimi është zhvilluar në shkelje të kuadrit ligjor dhe si i tillë, KQZ-ja nevojitet të sanksionojë Kryeministrin, Ministren e Arsimit dhe Sportit, Kryetaren në detyrë të Bashkisë Tiranë, Drejtuesin/en e Shkolles “Besnik Sykja”, si dhe subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet, bazuar në nenet 171 dhe 172 të Kodit Zgjedhor.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

Me konsideratë,

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhja Nr. 1: Pasqyrimi me foto dhe link-e i publikimit të aktivitetit.

1.1. Aktiviteti i zhvilluar është publikuar [në faqen zyrtare të internetit](#) të Kryeministrit, me përmbajtjen si më poshtë:

“Transformim i infrastrukturës arsimore dhe rritje e cilësisë së sistemit arsimor për Shqipërinë 2030 në BE”.



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.2. Aktiviteti i zhvilluar është publikuar [në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit](#), me përmbajtjen si më poshtë:

“Rama-Manastirliu: Transformim rrënjësor i infrastrukturës arsimore, program i ri pas shkolle për fëmijët, rrisim pagat e mësuesve në 1250 euro.”



Rama-Manastirliu: Transformim rrënjësor i infrastrukturës arsimore, program i ri pas shkolle për fëmijët, rrisim pagat e mësuesve në 1250 euro

Tiranë, 2 prill – Transformimi rrënjësor i infrastrukturës arsimore ka qenë një nga prioritetet kryesore të qeverisë gjatë këtyre dhjetë viteve. Me 450 objekte arsimore dhe sportive të ndërtuara ose rikonstruktura në të gjithë vendin, rreth 200 mijë nxënës dhe mësues kanë sot kushte dinjitoze dhe bashkëkohore për të mësuar dhe mësuar.

Në kuadër të këtij transformimi, në ambientet e shkollës “Besnik Sykja” në Tiranë, Kryeministri Edi Rama, Ministra e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, dhe kryetarja e komanduar e Bashkisë Tiranë, Anuella Ristani, zhvilluan një takim me mësues dhe përfaqësues të komunitetit të prindërve, për të vënë në fokus ecurinë e investimeve në arsimin publik dhe vizionin për të ardhmen.

Kryeministri Edi Rama, duke iu referuar vendimit për mbylljen e TikTok-ut, theksoi se është e rëndësishme ndërveprimi mes prindërve, shkollës, fëmijëve dhe institucioneve. “Ne do të bëjmë të pamundurën që shkolla të rrisë në mënyrë të ndjeshme fluksin e informacioneve për prindërit, jo më vetëm notat dhe mungesat, por edhe raporte të dedikuara dhe të individualizuara për çdo fëmijë, dhe do të bëjmë çmos që të rrisim e të zgjerojmë hapësirën që mund t’u ofrojmë nxënësve pas mësimit, duke fuqizuar programet e sportit, artit, zejeve dhe duke rritur numrin e adresave ku fëmijët mund të kenë aktivitet,” tha Kryeministri Edi Rama.

Duke folur për mbështetjen për mësuesit, Kryeministri Edi Rama tha: “Plani ynë është që në vitet e ardhshme, brenda kësaj dekade, ne pagat e mësuesve do t’i çojmë në 1250 euro”

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, duke vënë theksin te investimet në infrastrukturën arsimore, tha se vetëm në Tiranë janë rikonstruktuar dhe rindërtuar 48 shkolla, duke u krijuar mundësi me të mira rreth 38 mijë nxënësve dhe mësuesve.

“450 shkolla janë rindërtuar, janë rehabilituar dhe rikonstruktuar në gjithë vendin. Vetëm në Tiranë janë 48 shkolla të reja që u shërbejnë sot më shumë se 38 mijë nxënësve në Tiranë. Vetëm për këtë vit ne do të bëjmë të mundur që 40 shkolla të tjera të rehabilitohen apo të rindërtohen nga Shkodra, Kukësi, Dibra deri në jug të vendit, në Sarandë, Gjirokastrë, dhe do të jenë 40 kantiere të reja të cilat hapen, që do të kemi mundësi jo vetëm të përmirësojmë infrastrukturën shkollore, por dhe të ofrojmë një cilësi të re shërbimi arsimor, sepse të gjitha këto shkolla kanë parametra bashkëkohorë: jo vetëm klasa, jo vetëm laboratorë, por edhe terrene sportive dhe palestra. Janë 200 palestra dhe terrene sportive që i janë shtuar infrastrukturës arsimore në të gjithë vendin,” tha Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu.

Ministria Manastirliu foli edhe për programin e ri pas shkolle për nxënësit.

“Ne tashmë kemi nisur punën për të pasur një program të ri, që lidhet direkt me kërkesën e prindërve një kërkesë që është programi i ushqimit në shkolla dhe programi pas-shkolle për të gjithë fëmijët, por edhe për prindërit që duan të kenë lehtësi dhe janë të angazhuar me punë. Ky program do të fillojë fillimisht në bashkitë qendër qarku dhe më pas do të vijojë edhe në bashkitë e tjera,” tha Manastirliu.

Po ashtu, qeveria, tha Ministria Manastirliu, është e angazhuar për të forcuar figurën e mësuesit, jo vetëm përmes përmirësimit të kushteve të punës dhe rritjes së pagave por dhe zhvillimit profesional të tyre.

“Shtylla e sistemit tonë arsimor janë mësuesit, ndaj mbështetja për mësuesit ka qenë në mënyrë të vazhdueshme. Paga mesatare për mësuesit sot është 950 euro, por ajo që kemi mundësuar është sistemi i ri i zhvillimit profesional të mësuesve, që do të ridimensionojë tërësisht edhe mënyrën sesi i qaset një mësues kurrikulës së re, aftësi të reja dhe kompetencave që kërkohen sot në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ne mundëm jo vetëm të riorganizojmë sistemin e kualifikimit të mësuesit, duke dyfishuar përfitimet për mësuesit që marrin gradën e mësuesit të kualifikuar, specialist apo mjeshtër, dhe nga ana tjetër për herë të parë të garantojmë që sistemi i trajnimeve dhe krediteve të perfutuara për

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana


Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.3. Publikimi në fagen zyrtare në Facebook të Kryeministrit:

Postimi me përshkrimin:

“Shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë - Transformimi i infrastrukturës arsimore, rritja e pagave për mësuesit, programet e reja jashtëshkollore për nxënësit dhe rritja e cilësisë së sistemit tonë arsimor janë sot një realitet i ri, drejt Shqipërisë2030 në Bashkimin Europian 🇪🇺🇦🇪”



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana



Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.4. Publikimi në [faqen zyrtare](#) në Facebook të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

Postimi me përshkrimin:

“Shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë - Transformimi i infrastrukturës arsimore, rritja e pagave për mësuesit, programet e reja për nxënësit dhe rritja e cilësisë së sistemit tonë arsimor janë sot një realitet i ri, drejt Shqipërisë2030 në Bashkimin Europian🇲🇪🇷🇸🇪🇺”.



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana



Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.5. Publikimi në [faqen zyrtare në Facebook](#) të Bashkisë Tiranë:

[Postimi](#) me përshkrimin:

“Shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë - Transformimi i infrastrukturës arsimore, rritja e pagave për mësuesit, programet e reja për mësuesit dhe rritja e cilësisë së sistemit tonë arsimor janë sot një realitet i ri, drejt Shqipërisë2030 në Bashkimin Europian🇲🇪🇷🇸🇪🇺”.



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana



Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.6. Publikimi në [faqen zyrtare në Facebook](#) të Shkollës “Besnik Sykja”:

[Postimi](#) me përshkrimin:

“Shkolla “Besnik Sykja”, Tiranë - Transformimi i infrastrukturës arsimore, rritja e pagave për mësuesit, programet e reja për nxënësit dhe rritja e cilësisë së sistemit tonë arsimor janë sot një realitet i ri, drejt Shqipërisë2030 në Bashkimin Europian 🇪🇺🇦🇷🇷🇪”.



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.7. Disa nga mediat të cilat e transmetuan Live veprimtarinë, e pasqyruan në faqet e tyre online, si dhe në edicionet e tyre informative:

1.7.1. Agjensia Telegrafike Shqiptare, “[Manastirliu: 40 kantiere të reja ndërtimi dhe rehabilitimi të shkollave në vitin 2025](#)” :



The screenshot shows the homepage of the Agjensia Telegrafike Shqiptare (ATA) website. The main headline reads: "Manastirliu: 40 kantiere të reja ndërtimi dhe rehabilitimi të shkollave në vitin 2025". Below the headline is a video player showing a woman speaking at a podium. To the right of the main article, there is a sidebar with a "Lajme" (News) section containing several smaller news items with thumbnails and brief descriptions.

1.7.2. TV Ora News, “[Rama në shkollën “Besnik Sykja”: Mbyllja e TikTok ka qenë hapi i duhur, do mbrojmë adoleshentët](#)”:



The screenshot shows the TV Ora News website during a live broadcast. The main headline reads: "LIVE 'SHKOLLA ME KUSHTET MË TË MIRA PËR FËMIJËT' RAMA NË SHKOLLËN 'BESNIK SYKJA'". The background features a large graphic with the text "MANDATI/KATËRTI: 1250€ PAGA MESATARE E MËSUESIT". On the right side, there is a "FLASH" section with a headline: "Raporti i SPAK: Presioni i krimit, politikës dhe ai mediatik çënon pavarësinë dhe efektivitetin në hetime". The bottom of the screen shows a news ticker with the text: "TODAY'S: GABON'S OLD GUARD PM 'BILIE' CHALLENGES COUP LEADER FOR PRESIDENCY".

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.7.3. Top Channel TV, “Top Channel/ Rama si Starmer, propozon transmetimin e serialit “Adoleshenca” në shkolla”:



1.7.4. RTV Klan, “Seriali që tronditi botën, Rama me prindërit: Ta shfaqim në shkolla “Adoleshencën””



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

1.7.5. RTV Klan – Lajme, [“Tv Klan - Rama: Paga e arsimtarëve 1250 Euro brenda kësaj dekade | Lajme News”](#)



1.7.6. Report TV, [“Rama: Mësuesit janë po aq të rëndësishëm sa ushtria, paga mesatare 1250 euro brenda dekadës”](#)



Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania